

**“Liria ka Emër”
po merr mbështetje
për marshin
e 17 shkurtit** FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEZIU: MANIPULIMI I VOTAVE NUK KA QENË AS I RASTËSISHËM, AS I IZOLUAR

FAQE 4-5



Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se rastet në Podujevë, Pejë dhe komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë as i rastësishëm dhe as i izoluar. Ai ka thënë të enjten se ky proces ka qenë i orkestruar dhe gjithëpërfshirës, duke mos u kufizuar në një komunë, një kandidat apo një subjekt të vetëm politik. Kjo, sipas Kryeziut, e thëllon ndjeshëm dëmin ndaj besimit publik në procesin zgjedhor. “Krijon një precedent të rrezikshëm: manipulimi shndërrohet në një strategji me kosto të ulët, ku përgjegjësia penale bie mbi komisionarët, ndërsa përfitimi politik mbetet te kandidatët dhe partitë”, është shprehur Kryeziu

**FONDET
E KOSOVËS
PËR LUGINËN
E PRESHEVËS
NDEZIN PËRPLASJE
POLITIKE** F. 4-5



**PDK-ja: PROKURORIA
T’I HETOJË PAMJET
E RREME TË
PUBLIKUARA NGA
KURTI PËR FABRIKËN
E PRODHIMIT
TË DRONËVE** F. 5



SPORT



**FIFA DHE UEFA KONFIRMOJNË
NDRYSHIMET STATUTORE TË FFK-së
DHE KËRKOJNË PROCES ZGJEDHOR
PA NDËRHYRJE NGA PALË TË TRETA**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI: IRANI TË ARRIJË NJË MARRËVESHJE OSE SULMI I ARDHSHËM I SHBA-së DO TË JETË SHUMË MË I KEQ

UASHINGTON, 29 JANAR - Presidenti amerikan Donald Trump përsëriti thirrjen e tij për Iranin që të “arrijë një marrëveshje” për programin e tij bërthamor ose në të kundërtën do të përballet “me sulmin më të keq deri më tani”, më i ashpër sesa sulmet e vitit të kaluar kur sulmet ajrore amerikane dhe izraelite shënjestruan ndërtesat bërthamore iraniane. Trumpi ka kërcënuar me sulme ushtarake kundër Iranit pas një shtypjeje brutale ndaj protestave antiqeveritare, për të cilat grupet e të drejtave të njeriut dhe dëshmitarët okularë thonë se lanë mijëra të vrarë. Shtetet e Bashkuara ditët e fundit kanë dislokuar avionë luftarakë, sisteme të mbrojtjes ajrore dhe atë që Trumpi e ka quajtur një “flotë” në Lindjen e Mesme, një lëvizje që ka rritur tensionet me Iranin dhe ka shtuar gjasat për veprime ushtarake, sipas ekspertëve. “Shpresojmë që Irani të vijë shpejt ‘në tryezë’ dhe të negociojë një marrëveshje të drejtë dhe të barabartë - pa armë bërthamore - një marrëveshje që është e mirë për të gjitha palët”, tha Trumpi

në një postim në rrjetet sociale më 28 janar. “Koha po mbaron! Siç i thashë Iranit edhe më parë, arrini marrëveshje! Ata nuk e bënë, dhe ndodhi Operacioni Çekani i Mesnatës, një shkatërrim i madh i Iranit. Sulmi i radhës do të jetë shumë më i keq!”. Komanda Qendrore e ShBA-së njoftoi më 27 janar se një grup aeroplanmbajtësish amerikanë, nën drejtimin e USS Abraham Lincoln, ndodhej në ujërat e Lindjes së Mesme. Duke folur para deklaratave të Trumpit, ministri i Jashtëm iranian tha se negociatat me Uashingtonin nuk mund të zhvillohen në një atmosferë të kërcënimeve ushtarake. Abbas Araqhchi, sipas medias shtetërore ISNA, tha më 28 janar se “ushtrimi i diplomacisë përmes kërcënimit ushtarak nuk mund të jetë efektiv ose i dobishëm”. Ai shtoi se nuk kishte pasur “asnjë kontakt” me të dërguarin amerikan Steve Witkoff në ditët e fundit dhe se “Irani nuk ka kërkuar negociatë”. Trumpi, nga ana tjetër, tha në një intervistë për “Axios” më 26 janar se Teherani kishte “thirrur në shumë raste”.



Kriza ekonomike

Irani është përfshirë në trazira që nga 28 dhjetori i vitit 2025, kur protestues paqësorë filluan të dilnin në rrugët e Teheranit për të kërkuar nga autoritetet që të ndalonin inflacionin dhe zhvlerësimin e valutës. Përleshjet u përhapën në të gjithë vendin dhe u shndërruan në një veprim më të gjerë kundër pushtetit, duke nxitur një përgjigje masive dhe vdekjeprurëse nga autoritetet, që shkaktoi zemërim në mbarë botën. Organizata amerikane për të drejtat e njeriut HRANA, të cilën Radio Evropa e Lirë e ka

cituar rregullisht që nga fillimi i shtypjes së dhunshme në Iran këtë muaj, raporton se numri i viktimave të konfirmuara, duke përfshirë edhe në anën e forcave të sigurisë, është 6 221, ndërsa numri i të vdekurve që janë ende nën hetim është 17 091. Më shumë se 42 000 persona janë arrestuar. Disa medie, duke cituar zyrtarë të paidentifikuar, kanë raportuar se numri i viktimave është shumë më i lartë.

Marrëveshja e dështuar bërthamore

Më 2015 Irani u pajtua për një marrëveshje historike me

fuqitë botërore, që synonte parandalimin e zhvillimit të një arme bërthamore nga Republika Islamike në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ekonomike. Por, ai filloi të tërhiqej nga zotimet e tij pasi Trumpi, gjatë mandatit të tij të parë presidencial, tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja në vitin 2018 dhe rivendosi sanksione ndaj Teheranit. Irani ndërpreu bashkëpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore në korrik të vitit 2025 si përgjigje ndaj bombardimeve amerikane dhe izraelite ndaj ndërtesave kyçe bërthamore në Fordo, Isfahan dhe Natanz. Sanksionet që lidhen me marrëveshjen bërthamore dhe çështje të tjera kanë dëmtuar rëndë ekonominë iraniane, gjë që herë pas here ka shkaktuar protesta për shkak të rritjes së çmimeve dhe mungesës së mallrave dhe furnizimeve me energji. Protestat e fundit vlerësohen gjerësisht si sfida më e madhe ndaj Republikës Islamike që nga revolucionin e vitit 1979.

KALLASI THOTË SE BE-ja PRITET TA FUSË GARDËN REVOLUCIONARE TË IRANIT NË LISTËN E ORGANIZATAVE TERRORISTE

BRUKSEL, 29 JANAR - Bashkimi Evropian (BE) ka shumë gjasa ta përfshijë Gardën Revolucionare Islamike të Iranit në listën e organizatave terroriste, tha të enjten shefja e politikës së jashtme të bllokut, Kaja Kallas, në prag të mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme. “Po vendosim sanksione të reja ndaj Iranit dhe gjithashtu pres që ta fusim Gardën Revolucionare Islamike në listën e organizatave terroriste”, tha Kallasi. “Nëse vepron si terrorist, duhet të trajtohesh si terrorist”, u tha diplomatja e lartë, Kaja Kallas, gazetarëve para takimit të ministrave në Bruksel. Ajo tha se ky hap e vendos Gardën Revolucionare në të njëjtin nivel me grupet xhihadiste si Al-Kaeda dhe Shteti Islamik. Ky veprim nga BE-ja do t'i dërgonte Iranit mesazh të fortë dënimi, pasi raportohet se mijëra njerëz janë vrarë gjatë

protestave që tronditën vendin. Blloku prej 27 shtetesh pritet gjithashtu të vendosë regjim vizash dhe t'i ngrijë asetet për 21 entitete shtetërore dhe zyrtarë iranianë - përfshirë edhe për ministrin e Brendshëm të vendit - për shkak të shtypjes vdekjeprurëse të protestave. Autoritetet iraniane e pranojnë se mijëra njerëz janë vrarë gjatë protestave, duke dhënë një shifër prej mbi 3.000 viktimash, por thonë se shumica ishin pjesëtarë të forcave të sigurisë ose kalimtarë të vrarë nga “protestuesit trazues”. Organizatat për të drejtat e njeriut e kundërshtojnë këtë, duke thënë se numri i viktimave është shumë më i lartë dhe me gjasë kap shifrën e dhjetëra mijërave. Sipas tyre, protestuesit u vranë nga forcat e sigurisë, përfshirë Gardën Revolucionare, të cilat qëlluan drejtpërdrejt mbi protestues. Garda Revolucionare Islamike e

Iranit, apo IRGC, është krahu ideologjik i ushtrisë së Teheranit dhe u krijua pas revolucionit të vitit 1979 për ta mbrojtur udhëheqjen klerikale. Garda kontrollon ose zotëron kompani në gjithë ekonominë iraniane, përfshirë sektorë strategjikë kryesorë. “Vlerësimi është se kanalet diplomatike do të mbeten ende të hapura edhe pas përfshirjes së Gardës Revolucionare në listë”, tha Kallasi. IRGC-ja pritet të përfshihet në listën e zezë pasi Franca njoftoi të mërkurën se po e mbështeste këtë hap, dhe pasi edhe Italia e kishte ndryshuar qëndrimin paraprakisht. Parisi ngurronte ta mbështeste shpalljen e IRGC-së organizatë terroriste për shkak të frikës nga ndikimi mbi evropianët e ndaluar në Iran dhe dëshirës për t'i mbajtur të hapura lidhjet diplomatike. “Nuk mund të ketë pandëshkueshmëri për krimet e kryera”, u tha



gazetarëve kur mbërriti në Bruksel ministri i Jashtëm francez, Jean-Noel Barrot. BE-ja i ka sanksionuar tashmë disa qindra zyrtarë dhe entitete iraniane për shtypjen e lëvizjeve të mëparshme protestuese dhe për mbështetjen e Teheranit për

luftën e Rusisë në Ukrainë. IRGC-ja si e tërë dhe komandantët e saj të lartë janë tashmë nën sanksione të BE-së, që do të thotë se përfshirja e saj në listën e organizatave terroriste pritet të ketë pak ndikim praktik mbi këtë organizatë.

KRYEZIU: MANIPULIMI I VOTAVE NUK KA QENË AS I RASTËSISHËM, AS I IZOLUAR

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se rastet në Podujevë, Pejë dhe komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë as i rastësishëm dhe as i izoluar. Ai ka thënë të enjten se ky proces ka qenë i orkestruar dhe gjithëpërfshirës, duke mos u kufizuar në një komunë, një kandidat apo një subjekt të vetëm politik. Kjo, sipas Kryeziut, e thëllon ndjeshëm dëmin ndaj besimit publik në procesin zgjedhor. “Krijon një precedent të rrezikshëm: manipulimi shndërrohet në një strategji me kosto të ulët, ku përgjegjësia penale bie mbi komisionarët, ndërsa përfitimi politik mbetet te kandidatët dhe partitë”, është shprehur Kryeziu

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i fletëvotimeve sipas listës së vendvotimeve për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendim që të rinumërohen.

Nga fillimi i këtij procesi, 13 janar 2026, ora 18:00 dhe deri të enjten, 29 janar 2026, ora 10:00, janë rinumëruar rreth 88 % apo 2 245 nga 2 557 vendvotime. Do të thotë se 34 komuna kanë përmbyllur procesin e rinumërimit të votave.

Të enjten Prokuroria Themelore në Prizren ka bërë me dije se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në Prizren, si dhe Drejtorinë Rajonale të Policisë në Prizren, pas pranimit të informatave publike lidhur me procesin e rinumërimit të rezultateve të votimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), respektivisht në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prizren, po vazhdojnë hetimet e zgjeruara lidhur me grupin e dytë të dyshuarve, në Prizren. Hetimet kanë të bëjnë me dyshimet për kryerjen e veprave penale të parashikuara në Kapitullin XVIII lidhur me shkeljen e të drejtave të votimit dhe Kapitullit XXXIII Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Duke marrë parasysh interesimin e madh të medie, Prokuroria Themelore në Prizren njofton se gjatë ditës, pas intervistimit



të të dyshuarve në polici, do të lëshohet një komunikatë shtesë me informacione mbi veprimet dhe zhvillimet e mëtejme hetimore.

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se rastet në Podujevë, Pejë e komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë as rastësor. “Rastet në Podujevë, Pejë e komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë as rastësor dhe as i izoluar. Ai ka thënë i orkestruar dhe gjithëpërfshirës, duke mos u kufizuar në një komunë, një kandidat apo një subjekt të vetëm politik. Kjo e thëllon ndjeshëm dëmin ndaj besimit publik në procesin zgjedhor”, ka thënë ai. Sipas Kryeziut, teknikisht, rinumërimi ka korrigjuar keqpërdorimet dhe ka rikthyer numrin real të votave për secilin kandidat. “Megjithatë, problemi kryesor

nuk qëndron më te rezultati - i cili mund të krijojë përbërjen e njëjtë të kuvendit, me atë të para rinumërimit - por te besueshmëria e procesit zgjedhor, e cila është dëmtuar rëndë”, është shprehur ai.

Kryeziu ka thënë se fakti që shumica e kandidatëve, edhe pas largimit të votave të keqpërdorura, mund të certifikohen si deputetë, nuk e zhbën këtë dëm. “Përkundrazi, krijon një precedent të rrezikshëm: manipulimi shndërrohet në një strategji me kosto të ulët, ku përgjegjësia penale bie mbi komisionerët, ndërsa përfitimi politik mbetet tek kandidatët dhe partitë. Kështu krijohet një paradoks serioz: procesi pranohet si i rregulluar ligjërisht, por mbetet i komprometuar moralisht. Për mua kjo është e qartë. Për kandidatët dhe partitë e tyre, pyetja thelbësore mbetet: a është i pranueshëm një mandat politik i ndërtuar

mbi një proces të manipuluar, edhe nëse ai më pas korrigjohet? Në demokraci, ligjshmëria formale nuk mjafton pa legjitimitet etik dhe moral”, ka thënë Kryeziu.

Të mërkurën ndaj 15 kryesuesve zgjedhorë në komunën e Malishevës është caktuar masa e ndalimit prej 48-orësh, pas aksionit në këtë komunë lidhur me dyshimet për manipulime të votave të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 28 dhjetorit.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Enis Gashi, tha se gjatë aksionit cak ishin 18 kryesues dhe 50 komisionarë. Ai tha se u intervistuan 15 kryesues, që u dërguan në ndalim dhe 43 komisionarë. Për komisionarët tha se do të vendoset nëse do të ndërmerret ndonjë masë sigurie. Megjithatë, në hetimet e deritanishme për manipulim të votave, të dyshuar që janë marrë në pyetje kanë qenë

komisionarë dhe vëzhgues që kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në numërimin e votave.

Rinumërimi në Malishevë, komunë në pjesën qendrore të vendit ka përfunduar tashmë dhe ai tregon një dallim në votat për kandidatët për deputetë.

Ky operacion është i dyti i këtij lloji si pjesë e një hetimi të gjerë për manipulim të votave në zgjedhjet e fundit të parakohshme të Kosovës.

Një operacion i ngjashëm u krye javën e kaluar në Prizren, ku u arrestuan 109 të dyshuar, prej të cilave 23 u dërguan në paraburgim nën dyshimin se kishin manipuluar vota të kandidatëve për deputetë.

Dyshimet për manipulim të votave të zgjedhjeve të dhjetorit kanë hedhur dyshime serioze mbi procesin zgjedhor, dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u detyrua ta bëjë rinumërimin e plotë të votave, pasi kishte gjetur mospërputhje të mëdha në votat për kandidatët për deputetë.

Trajtimi i rasteve që lidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ishte temë diskutimi në takimin e kolegjiut të u. d. Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e prokurorive. Në këtë takim, i cili u mbajt të mërkurën, u kërkuar nga të gjithë kryeprokurorët që rastet e ndërlydhura me këtë proces zgjedhor të trajtohen me prioritet, konkretisht rastet e keqpërdorimit dhe falsifikimit të votës, me qëllim të trajtimit sa më efikas të të gjitha rasteve në nivel vendi

KQZ-ja bërë me dije se pret ta përfundojë rinumërimin në fundjavë, pasi tashmë janë rinumëruar rreth 88 për qind e votave.

Osmani për Bordin e Paqes: Vlerësimi nga ShBA-ja forcon subjektivitetin e Kosovës

PRISHTINË, 29 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka vlerësuar përfshirjen e Kosovës në Bordin e Paqes si një nga zhvillimet më të rëndësishme të politikës së jashtme të vendit në vitet e fundit, duke theksuar se ky hap e fuqizon drejtpërdrejt subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. “Anëtarësimi i Kosovës në secilën organizatë

ndërkombëtare është lajm i mirë për vendin tonë, e në veçanti kur po flasim për një organizatë ndërkombëtare që udhëhiqet nga aleati ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shteti kryesor që nëpërmjet ndihmës, bashkërendimit dhe udhëheqjes, leadershipit të vet ia ka bërë Kosovës të mundur lirinë, pavarësinë, demokracinë dhe paqen që e

gëzojmë”, tha Osmani për Telegrafin.

Ajo ka thënë se Kosova është vlerësuar nga ShBA. “Ky është një vlerësim i jashtëzakonshëm i popullit tonë dhe i shtetit tonë si faktor i rëndësishëm për paqe dhe stabilitet, jo vetëm në rajon, por edhe përtej. Në anën tjetër, kjo fuqizon subjektivitetin e pozicionin ndërkombëtar të shtetit”, ka deklaruar Osmani.





FONDET E KOSOVËS PËR LUGINËN E PRESHEVËS NDEZIN PËRPLASJE POLITIKE

Qeveria e Kosovës ndan prej vitesh fonde për mbrojtjen e të drejtave, arsimin dhe kulturën e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por shpërndarja e tyre shkakton debate politike. Partitë lokale akuzojnë Këshillin Kombëtar Shqiptar (KKSH) dhe njëra-tjetrën për keqpërdorim dhe favorizim, ndërsa KKSh-ja dhe zyrtarë të Qeverisë në detyrë të Kosovës mohojnë keqpërdorimin dhe vënë në dukje realizimin e projekteve konkrete

PRISHTINË, 29 JANAR - Milionat e ndara prej vitesh nga Qeveria e Kosovës për Luginën e Preshevës - të menduara si mbështetje për mbijetesën kombëtare të shqiptarëve në jug të Serbisë - kanë hapur një front të brendshëm politik. Partitë shqiptare atje akuzojnë njëra-tjetrën për keqpërdorim të fondeve, favorizim selektiv dhe mungesë transparence. Në qendër të debatit është roli i Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKSH) - institucioni përmes të cilit menaxhohen mjetet si dhe raportet e tij me partitë politike lokale.

Ky këshill dhe Qeveria e Kosovës nënshkruan në vitin 2022 Memorandumin për Bashkëpunim, me qëllim “mbrojtjen dhe promovimin e

të drejtave të shqiptarëve, si dhe ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, artit, kulturës dhe identitetit shqiptar në Luginën e Preshevës”.

Në dy vjetët e parë të zbatimit të memorandumit fondi i ndarë nga Qeveria e Kosovës ishte nga 2 milionë euro për secilin vit. Më 2024 kjo shumë u rrit në 3 milionë euro, ndërsa më 2025 në 4 milionë euro - ndonëse realizimi i mjeteve të fundit nuk ka nisur ende.

Ku shkojnë këto para?

Kryetari i komunës së Bujanocit, Arbër Pajaziti, nga koalicioni Fronti për Ndryshim, thotë se fondet e ndara nga Qeveria e Kosovës nuk kanë prodhuar rezultate

të dukshme në terren. “Nuk mund të shihni një shenjë konkrete që ka mbetur nga të gjitha këto mjete që i jep Qeveria e Kosovës”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Ai thekson se kritikën e tij nuk kanë për qëllim ta vënë në pikëpyetje mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për Luginën e Preshevës të cilën e konsideron të domosdoshme, por mënyrën se si, sipas tij, ajo menaxhohet. Sipas Pajazitit, veçanërisht fondi i vitit 2022 - i ekzekutuar një vit më pas - është keqpërdorur nga KKSh-ja dhe persona të lidhur me Partinë për Veprim Demokratik (PVD).

Ai pretendon se një pjesë e mjeteve u janë shpërndarë organizatave joqeveritare, prapa të cilave, sipas tij, qëndrojnë persona të afërt me këtë parti që udhëheq KKSh-në. “Një pjesë e mirë e fondeve ka përfunduar në xhepa të funksionarëve partiakë”, thotë Pajaziti, duke shtuar se, për këtë arsye, shumë mjete të ndara në vitin 2023 nuk janë realizuar për projekte të shoqërisë civile, por vetëm për furnizimin e nxënësve me libra shkollore dhe për bursat e studentëve. Pa sjellë ndonjë provë më konkrete, Pajaziti ka bërë

pretendime të ngjashme edhe në komentet për disa medie në Serbi.

Kundërpërgjigjja e KKSh-së dhe komunat e tjera

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Enkel Rexhepi, i hedh poshtë këto pretendime. Ai thotë se fondet janë shfrytëzuar për projekte konkrete dhe se përfituesit nuk janë përzgjedhur mbi baza partiake. “Efektet nuk maten nga deklaratat politike, por në terren - në media, në institucione, në projekte kulturore dhe në jetën reale të qytetarëve”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas Rexhepit, fondi prej dy milionë eurosh i vitit 2022 u ekzekutua 100 për qind gjatë vitit pasues, ndërsa më 2023 u realizua vetëm 14.5 për qind për shkak të vonesave nga zgjedhjet brenda KKSh-së. Për vitin 2024, nga tre milionë euro janë ekzekutuar 60.96 për qind, ndërsa shpërndarja e 4 milionë eurove të vitit 2025 parashikohet të arrijë në 78.39 për qind përmes konkurseve publike të shpallura nga KKSh-ja.

Rexhepi përmend si shembull

funksionimin e televizioneve lokale, mbështetjen e klubeve sportive, si dhe shpërndarjen falas të librave shkollore për mbi 30 mijë nxënës të shkollave fillore në Luginë. Sipas tij, qindra studentë kanë përfituar gjithashtu bursa për studime. “Duhet ta kuptojmë se jetojmë në një komunitet të vogël dhe, si kudo tjetër, organizatat dhe individët janë shpesh të ndërlidhur përmes angazhimeve profesionale, shoqërore apo edhe politike. Kjo nuk nënkupton keqpërdorim, por është realitet i shoqërive të vogla”, thotë Rexhepi.

Ai shton se në projekte kanë qenë të angazhuar edhe profesionistë të afërt me koalicionin Fronti për Ndryshim, prej nga vjen Pajaziti.

Ky koalicion - në përbërje të të cilit janë Alternativa për Ndryshim, Lëvizja për Reforma dhe Lëvizja për Bujanocin - aktualisht nuk ka përfaqësim në KKSh.

Aty janë të përfaqësuar Partia për Veprim Demokratik, Lëvizja e Progresit Demokratik, Partia Demokratike e Bujanocit dhe Partia Demokratike Shqiptare. Kryetarja e komunës së Preshevës, Ardita Sinani, nga

Partia për Veprim Demokratik, vlerëson se mbështetja financiare e Qeverisë së Kosovës ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

“Përfitimet janë të prekshme dhe shumëdimensionale, si në Preshevë ashtu edhe në mbarë Luginën e Preshevës”, thotë ajo për Radion Evropa e Lirë. Sipas Sinanit, ndihma ka përfshirë disa sektorë kyçë, veçanërisht arsimin, ku nxënësit kanë përfituar libra falas, ndërsa studentët bursa. Ajo shton se janë mbështetur edhe klubet sportive për të rinj dhe fëmijë, është zbatuar një program i posaçëm për përkrahjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe është financuar renovimi i një objekti që po shndërrohet në Shkollë Muzike dhe Muze në komunën e Preshevës.

Në kuadër të kësaj mbështetjeje, Sinani përmend edhe financimin e aktiviteteve lobuese për ndërkombëtarizimin e çështjes së shkëljes së të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Si rrjedhojë, një grup ligjvënësish amerikanë i kërkuan Departamentit amerikan të Shtetit javën e kaluar që t'i shqyrtojë pretendimet për diskriminim ndaj shqiptarëve në Serbi.

Afrim Ferati, një nga tre asamblastët shqiptarë në Kuvendin Komunal të Medvegjës dhe drejtues i degës së KKSh-së në këtë komunë, e konsideron mbështetjen financiare nga

Qeveria e Kosovës si të domosdoshme dhe pozitive për komunitetin shqiptar. Ai shmang përplasjet politike ndërmjet partive lokale dhe thekson mirënjohjen e komunitetit për ndihmën që vjen nga Kosova.

Ferati pranon se fondet mund të menaxhohen më mirë dhe me më pak procedura, por nuk beson në keqpërdorim masiv. “Unë nuk besoj tek ajo që flitet se ka pasur keqpërdorim masiv. Ndoshta mund të flasim për cilësinë e menaxhimit të mjeteve, por presim që të ketë përmirësim në procesin e ndarjes së tyre”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Qëndrimi i Qeverisë së Kosovës

Pretendimet për mungesë efektesh në terren i hedh poshtë edhe Qeveria në detyrë e Kosovës. “Nëse dikush pretendon se ‘nuk ka efekte të dukshme’, kjo është më së paku e pasaktë dhe nuk përkon apo reflekton me realitetin dhe ndikimin që ka pasur në jetën e shqiptarëve të Luginës mbështetja e dhënë nga institucionet tona”, thotë për Radion Evropa e Lirë Klisman Kadiu, këshilltar për medie i zëvendëskryeministrit në detyrë, Besnik Bislimi. Sipas tij, procesi përfshin mekanizma kontrolli, raportimi dhe monitorimi në çdo fazë të realizimit. “...dhe mjetet janë shfrytëzuar ekskluzivisht për financimin

e projekteve, në përputhje me Memorandumin për Bashkëpunim dhe shtojcat përkatëse”, shton ai.

Ndihmë apo instrument politik?

Megjithatë, kryetari i Bujanocit shpreh dyshimin se bashkëpunimi i Prishtinës është fokusuar kryesisht me PVD-në dhe jo me institucionet e zgjedhura lokale. Ai kujton se dy zyrtarë nga PVD-ja - Ardita Sinani, aktualisht kryetare e Komunës së Preshevës, dhe Ragmi Mustafi, kryetar i degës së PVD-së në Bujanoc - kanë qenë këshilltarë në kabinetin qeveritar të Kosovës, të drejtuar nga Albin Kurti. “Qeveria e Kosovës e ka ndihmuar dhe po e ndihmon vetëm Partinë për Veprim Demokratik”, të cilën, siç thotë ai, “dëshiron ta fuqizojë përmes fondit”.

Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës nuk deshën ta komentonin këtë pretendim.

Sinani, ndërkaq, i sheh akuzat në kontekstin e zhvillimeve politike lokale, duke përmendur rezultatet e zgjedhjeve komunale të vitit 2024 dhe krijimin e shumicës komunale në Bujanoc me votat e partive serbe.

Në këto rrethana, thotë ajo, retorika politike kushtëzohet shpesh nga nevoja për të ruajtur shumicën - gjë që reflektohet edhe në diskursin publik ndaj Kosovës.

Sipas saj, politizimi i mbështetjes nga Kosova nuk i

shërben interesit publik të qytetarëve të Luginës së Preshevës.

Mbështetja e bllokuar për bujqit

Në krejt këtë diskutim, një nga pikat më problematike mbetet mbështetja për bujqit shqiptarë të Luginës së Preshevës.

Rexhepi, nga KKSh-ja, pranon se rreth një milion euro të ndara për këtë qëllim, nuk janë realizuar, pasi janë bllokuar nga Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave në Serbi. Sipas tij, kjo ministri anuloi subvencionet për fermerët shqiptarë në janar të vitit 2025, me arsyetimin se KKSh-ja nuk ka kompetenca në fushën e bujqësisë, duke u mbështetur kështu edhe në një vendim të Gjykatës administrative në Nish.

Ai thotë se shkak për këtë vendim u bë edhe një shkresë e dërguar më herët nga Alternativa për Ndryshim - pjesë e Frontit për Ndryshim - e cila kishte njoftuar institucionet serbe për konkursin e shpallur nga KKSh-ja. “Pasojat i kanë pësuar drejtpërdrejt bujqit, të cilët nuk kanë asnjë faj në këtë përplasje politike”, thotë Rexhepi.

Pajaziti, në anën tjetër, thotë se ka ofruar zgjidhje, duke propozuar që fondet të barten në Komunën e Bujanocit për t’u shpërndarë përmes saj.

Por, Rexhepi e hedh poshtë

këtë mundësi, duke argumentuar se një gjë e tillë është e pamundur ligjërisht dhe do të rezultonte në shpërndarje të pabarabartë, pasi komuna është multietnike. Sipas tij, mbështetja financiare e Qeverisë së Kosovës është e dedikuar vetëm për komunitetin shqiptar në Luginën e Preshevës, dhe KKSh-ja e ka përgjegjësinë për avancimin e shqiptarëve në këto troje.

Rexhepi thekson se këshilli po ndërmerr të gjitha hapat ligjorë dhe institucionalë për të sfiduar vendimin e autoriteteve serbe dhe për të rikthyer mbështetjen për bujqit, duke komunikuar në mënyrë të rregullt me institucionet përkatëse, partnerët ndërkombëtarë dhe Qeverinë e Kosovës.

Ai insiston se pengesë kryesore për veprimtarinë e institucioneve të Kosovës në Luginën e Preshevës mbetet pushteti në Beograd dhe strukturat e tij lokale.

Në Luginë jetojnë më shumë se 60.000 shqiptarë, të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madh në Serbi, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022.

Përfaqësues i vetëm i tyre në Kuvendin e Serbisë është deputeti Shaip Kamberi nga Partia për Veprim Demokratik.

Përpjekjet për ta shndërruar ndihmën nga Kosova në temë përplasjesh politike “janë të dëmshme për interesin shqiptar”, përfundon Rexhepi.



Në Repartin e Diagnostikës në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” rikthehet në funksion laborator

RAHOVEC, 29 JANAR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Afrim Oruqi, ishin për vizitë në

Repartin e Diagnostikës në QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, për të parë nga afër situatën pas problemit të paraqitur në pajisje dhe në aparatura, ku tashmë laborator

rikthyer plotësisht në funksion dhe nga sot qytetarët mund t'i shfrytëzojnë shërbimet për kryerjen e disa prej analizave laboratorike shtesë.

“Mbetemi të përkushtuar në garantimin e shërbimeve shëndetësore funksionale dhe të qasshme për të gjithë qytetarët”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



MUSTAFA: FORMAT E PROPAGANDËS E DEFORMOJNË DEMOKRACINË NË LDK DHE MUND TA KTHEJNË KUVENDIN E THIRRUR NË ARENË PËRÇARJESH

PRISHTINË, 29 JANAR - Ish-kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka shkruar në “Facebook” për zhvillimet në LDK pas rezultatit që ky subjekt politik mori në zgjedhjet e 28 dhjetorit. Ai ka thënë se është munduar të mos përfshihet me opinione për çështje të rezultatit zgjedhor, në debate për dorëheqje apo se kush duhet të jetë e kush të mos jetë në krye të LDK-së, duke konsideruar se përgjegjësia për rezultatin është çështje etike, nuk është çështje e testimi dhe licencimit. Mustafa ka thënë se kjo zgjidhet në organet vendimmarrëse të LDK-së, jo në deklarimet e ndonjë dege, të ndonjë simpatizanti, josimpatizanti apo të ndonjë debutueseje boshe se kush duhet të shkojë e kush jo nga LDK-ja. “Në LDK

problemet më së paku mund të zgjidhen me tifozllëk, andaj format e tilla të propagandës e deformojnë demokracinë dhe mund ta bëjnë Kuvendin e thirrur arenë të përçarjeve, që nuk i nevojitet LDK-së, e cila akoma nuk është shëruar nga një Kuvend i tillë i para njëzet viteve. LDK-ja nuk meriton epitafe. Ata që e duan duhet ta duan me besim të plotë se LDK-ja ka potencial, ka forcë vetërregulluese dhe mund të ringritet si subjekt i fortë politik, i cili siguron balancë në ndërtimin demokratik të shtetit të Kosovës. Duhet ta kuptojnë se LDK-ja qëndron para çdo emri të përveçëm; se përveç me kryetarin e saj historik Ibrahim Rugova, LDK-ja nuk identifikohet me asnjë emër të veçantë”, ka thënë ai.



Mustafa ka shtuar se Kuvendi si organi më i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të duhej të sigurojë se LDK-ja nuk është parti as e vjetër as e re, por parti që zhvillohet mbi bazat e përcaktuara 36 vjet më parë me aktin themelues të saj si parti konservatore e qendrës së djathtë me orientim të

palëkundur euroatlantik. “LDK ka nevojë të rikonfirmojë se beteja e saj politike nuk është ankand se kush jap më shumë por ofertë se si ndërtohet një shtet perspektiv, i fortë dhe i qëndrueshëm. Se LDK-ja nuk mund të përdoret si platformë mbi të cilën do të ndërtohet diçka tjetër duke e shfrytëzuar emrin e

saj. Reformat në LDK i bëjnë njerëzit të cilët i kanë qëndruar besnik LDK-së, të hapur për ardhjet dhe ardhje të reja dhe njerëz të rinj. LDK-së nuk i nevojiten ndarjet në ne dhe ata; të vjetrit dhe të rinjtë; të mitë dhe të atyre para meje. Ajo ka nevojë të mendojë për forma dhe mekanizma që sjellin sa më shumë anëtarë, simpatizantë dhe votues. Ndërkaq, përgjegjësia në LDK të trajtohet si standard normal i etikës demokratike që nënkupton se rezultati ka pasojë. Kuvendi mund ta gjejë zgjidhjen më të mirë duke vlerësuar se çfarë është e dobishme për rritjen dhe progresin e LDK-së, për forcimin e unitetit të brendshëm të saj, për ofrimin e veprimtarëve dhe veprimtareve, sepse asnjë njeri në LDK nuk është i tepërt!”, ka deklaruar Mustafa.

PARTNERITET PËR ZHVILLIM: OEK-U DHE KONSULLATA NË STUTTGART DREJT INVESTIMEVE TË REJA



PRISHTINË, 29 JANAR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, u prit në një takim zyrtar nga Konsulli i Republikës së Kosovës në Stuttgart, Hamdi Berbatovci, me fokus forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe promovimin e investimeve në Kosovë. Gjatë takimit, konsulli Berbatovci shprehu gatishmërinë për përkrahje të plotë nga Konsullata, me qëllim lehtësimin e

komunikimit dhe lidhjeve ndërmjet bizneseve kosovare dhe investitorëve gjermanë. Ai vuri në pah potencialin e madh që ofron tregu i Kosovës për investime dhe bashkëpunim afatgjatë. Ky bashkëpunim pritet të bëhet edhe më i strukturuar pas themelimit të Komitetit Veprues Kosovë - Stuttgart, një iniciativë e përbashkët që do të shërbejë si platformë kryesore për

koordinimin e aktiviteteve ekonomike ndërmjet dy vendeve. Përmes këtij komiteti dhe angazhimit të drejtpërdrejtë të Konsullatës së Kosovës në Stuttgart dhe Odës Ekonomike të Kosovës, synohet ndërtimi i një ure të fuqishme bashkëpunimi, e cila do të ndikojë në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe në tërheqjen e investimeve strategjike për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

FILLIMI I GJYKIMIT TË THAÇIT PËR PROCESIN E DYTË SHTYHET PËR 27 SHKURT



HAGË, 29 JANAR - Gjykata Speciale ka njoftuar se fillimi i gjykimit në çështjen kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit është shtyrë për datën 27 shkurt. Rasti ishte paraparë të niste më 24 shkurt. “Më 28 janar

2026, gjykatësi i vetëm Kristofer Gosnell miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes së Hashim Thaçit dhe urdhëroi që gjykimi në çështjen kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit të fillojë të premtën, 27 shkurt 2026, në

vend se më 24 shkurt, siç ishte caktuar më parë”, thuhet në një njoftim. Ky është procesi i dytë në Hagë ndaj Thaçit dhe të tjerëve. Në këtë proces që pritet të nisë më 27 shkurt do të paraqiten tre dëshmitarë, natyra dhe përmbajtja e të cilëve është zbuluar nga Prokuroria.

FSK-ja mbështet Shqipërinë në një operacion kërkim-shpëtimi

PRISHTINË, 29 JANAR - Me kërkesën e autoriteteve të Republikës së Shqipërisë, Forca e Sigurisë Kosovës ka

angazhuar një kontingjent të Kërkim-Shpëtimit, të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Gardës Kombëtare

të FSK-së, i cili i është bashkuar Operacionit në Klos, të Republikës së Shqipërisë, për të

intervenuar në operacionin e kërkimit të një personi të humbur në rrjedhën e lumit Mat.



‘LIRIA KA EMËR’ PO MERR MBËSHTETJE PËR MARSHIN E 17 SHKURTIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

KAÇANIK, 29 JANAR - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Ismail Tasholli dhe Eliza Hoxha, kanë vizituar të enjten komunën e Kaçanikut, me ç’rast janë pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Sabedin Vishi.

Tasholli dhe Hoxha e kanë njoftuar kryetarin Vishi me misionin e platformës “Liria ka Emër” dhe me aktivitetet në kuadër të fushatës së mobilizimit qytetar për marshin “Drejtësi, jo politikë”, i cili do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. “E falënderojmë kryetarin për pritjen që na e bëri dhe gatishmërinë e tij për ta mbështetur pa rezervë marshin”, tha Tasholli. “Të gjithë bashkë, me kryetarin e Kaçanikut, me ekzekutivin, me kuvendin dhe me qytetarët i ftoj t’i bashkohen marshit”, shtoi

Hoxha.

Kryetari i komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi, u zotua se kjo komunë dhe qytetarët e saj do të mobilizohen për pjesëmarrje masive në këtë marsh. “Ftoj qytetarët e Kaçanikut që t’i bashkëngjiten marshit paqësor. Drejtësi për çlirimtarët, jo politikë”, bëri thirrje Vishi. Platforma “Liria ka Emër” do të vazhdojë takimet dhe aktivitetet në tërë komunat e Kosovës, me synim të një mobilizimi sa më të gjerë qytetar për marshin e 17 shkurtit në Prishtinë, me moton “Drejtësi, jo politikë”.

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës bën thirrje për pjesëmarrje masive në marshin e 17 shkurtit

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës (ShBPK) përmes një deklarate publike u

ka bërë thirrje ish-të burgosurve politikë dhe qytetarëve të Kosovës për pjesëmarrje masive në marshin e 17 shkurtit, me moton “Drejtësi, jo politikë”.

Në deklaratë, përfaqësuesit e kësaj shoqate shprehin indinjatën e tyre ndaj, siç e quajnë, shkarjes së drejtësisë në Dhomat e Specializuara në Hagë. “Të fyer nga kjo gjykatë e ngritur nga Kosova, por e përdorur nga krimi antishqiptar ruso-serb dhe jo vetëm, si dhe nga simbolika poshtëruese e caktimit të seancave të ‘deklaratave përmbyllëse’ në procesin kryesor kundër Jakup Krasniqit, Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, pikërisht në vigjilje të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ne, Shoqata e ish-të Burgosurve Politikë, mbështesim Marshin Protestues të thirrur nga shoqata ‘Liria ka Emër’ për datën 17 shkurt 2026”, është thënë në deklaratë.

Më tutje, ShBPK-ja u ka bërë thirrje degëve të saj në të gjithë



Kosovën, ish-të burgosurve politikë, ish-ilegalëve, si dhe mbarë qytetarëve, që t’i bashkohen protestës kundër asaj që e cilësojnë si padrejtësi të Gjykatës Speciale ndaj ish-drejtuesve të Republikës së Kosovës, bartësve të luftës çlirimtare të Kosovës dhe shtetit

të Kosovës.

Shoqata, po ashtu, fton për bashkëpunim shoqatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si dhe institucionet lokale, për ngjeshjen e radhëve dhe krijimin e kushteve për pjesëmarrje sa më masive në marshin e 17 shkurtit.

PDK-ja: PROKURORIA T’I HETOJË PAMJET E RREME TË PUBLIKUARA NGA KURTI PËR FABRIKËN E PRODHIMIT TË DRONËVE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 JANAR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Besa Kabashi-Ramaj, ka kërkuar hetim institucional për pretendimet mbi dronët dhe transparencë të plotë për fabrikën e municionit, pas raportimeve të medieve lidhur me vërtetësinë pamjeve të publikuara nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, gjatë fushatës zgjedhore.

Kabashi-Ramaj, duke thënë se ky mashtrim publik është problem institucional dhe i sigurisë kombëtare, theksoi se qytetarët duhet ta dinë të vërtetën. “Gjatë fushatës zgjedhore ish-kryeministri Kurti promovoi publikisht edhe përmes vizitës atë që u paraqit si fabrikë e prodhimit të dronëve ushtarakë në Gjilan, duke lënë të kuptohet se në Kosovë po prodhohen dronë dhe kapacitete të avancuara teknologjike për siguri”, theksoi ajo, duke shtuar se prodhimi i dronëve nuk është aktivitet simbolik apo promovues. “Ai



kërkon infrastrukturë të certifikuar, personel të specializuar inxhinierik, protokolle të sigurisë dhe mbikëqyrje shtetërore, licenca e autorizime të qarta ligjore, testime të shumta teknike dhe operative. Asnjë prej këtyre nuk mund të zëvendësohet me video promovionale apo me montazh vizual. Prodhimi real i dronëve është proces i gjatë, i

verifikueshëm dhe i dokumentuar, jo diçka që imitohet për kamera. Kur një kryeministër paraqet si kapacitet shtetëror diçka që nuk ka kaluar këto faza themelore, problemi nuk është vetëm etik. Problemi është institucional dhe i sigurisë kombëtare. Prandaj kërkojmë nga Prokuroria e Shtetit dhe institucionet e drejtësisë që ta

verifikojnë këtë mashtrim publik, keqpërdorim institucional dhe trajtim serioz në deklarimet e rreme në një sektor jetik për shtetin”, kërkoj më tej Kabashi-Ramaj. Ajo tha se siguria kombëtare e Republikës së Kosovës nuk duhet të jetë material për video promovuese, montazh, shfaqje për kamera e as nuk është pronë e një qeverie apo

kryeministri. “Situatë të ngjashme nga ish-kryeministri kemi pasur edhe me deklaratat për fabrikën e municionit, por asnjë qytetar nuk ka parë plan të qartë, partneritet industrial të certifikuar, standarde të sigurisë dhe cilësisë, apo afate të besueshme dhe të verifikueshme”, theksoi deputetja e PDK-së.

Kabashi-Ramaj tha se shtyllat e sigurisë së shtetit të Kosovës kanë qenë dhe duhet të mbeten ndërtimi gradual i kapaciteteve reale dhe të verifikuara të mbrojtjes, partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, anëtarësimi në NATO dhe bashkëpunimi i thellë me vendet aleate. “Kapacitetet reale të mbrojtjes përfshijnë forcimin profesional të FSK-së, planin 10-vjeçar për transformim duhet ta përfundojnë mbrojtjen ajrore dhe kundër - dronëve në koordinim me aleatët tanë, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike, si dhe qëndrueshmërinë shtetërore ndaj krizave”, shtoi ajo.

Përfaqësues të Policisë së Kosovës marrin pjesë në një forum ndërkombëtar në Turqi

PRISHTINË, 29 JANAR - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë, nënkolonel Basri Shabani dhe majori Ramadan Ahmeti, kanë përfaqësuar

Policinë e Kosovës në Forumin “Praktikat e Sigurisë Private në Turqi dhe në Botë”, i cili është mbajtur në Stamboll nga 26 deri më 28 janar 2026.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Policisë së Kosovës jo vetëm që forcon imazhin profesional por, gjithashtu, krijon mundësi konkrete për

avancim, duke shkëmbyer përvoja nga praktikat më të mira globale, që do të shërbejnë në forcimin e fushës së sigurisë.



BLLOKADA E KUFIJVE GODET BIZNESET E KOSOVËS DHE RRIT FRIKËN PËR ÇMIME MË TË LARTA

Bllokada e pikave kufitare nga transportuesit e rajonit ka ndaluar qarkullimin e mallrave drejt zonës Schengen, duke ndikuar drejtpërdrejt në importet dhe eksportet e Kosovës. Disa biznese të Kosovës me të cilat ka biseduar Radio Evropa e Lirë, përballen me vonesa, rrezikim kontratash dhe dëme financiare. Ekspertët paralajmërojnë për mundësinë e rritjes së çmimeve, duke nënvizuar nevojën për politika mbrojtëse dhe stimuj për prodhuesit vendorë

PRISHTINË, 29 JANAR - Kompania e Kosovës “Relux”, e cila prodhon ngjyra dhe fasada, po përjeton pasoja të menjëhershme nga bllokimi i pikave kufitare mes disa vendeve të rajonit dhe të BE-së: produktet e saj për në Britani të Madhe nuk kanë mundur të nisen sipas planit. Drejtuesi i kompanisë, Ramiz Gashi, thotë për Radion Evropa e Lirë se ai është eksportues i rregullt dhe, sipas marrëveshjes, prodhimet do të duhej të arrinin në destinacion brenda kësaj jave. Në të kundërtën, kontrata rrezikon të shkelet, të rinegociohet ose të dështojë fare. “Ne mund ta humbim këtë blerës, që është potencialisht më i rëndësishmi që kemi”, thotë Gashi për Radion Evropa e Lirë. Ai paralajmëron se vonesat mund t’i dëmtojnë edhe kontratat me partnerët e tjerë - në Gjermani dhe në Kroaci - duke rrezikuar kështu investimet e bëra me kredi bankare që duhet të shlyhen brenda afateve të caktuara.

Transportues nga Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi bllokuan që nga mesdita e 26 janarit disa pika kufitare, duke ndalur qarkullimin e mallrave drejt zonës Schengen të Bashkimit Evropian. Protesta e tyre është kundër sistemit të ri të BE-së për kontrollin e hyrje-daljeve, i njohur si EES. Ky sistem parasheh që shtetasit jashtë Schengenit të qëndrojnë në këtë zonë maksimumi 90 ditë brenda 180 ditësh por, sipas transportuesve protestues, kjo periudhë nuk mjafton - sidomos për ata që udhëtojnë në vende më të largëta - ndaj edhe shkakton humbje ekonomike dhe rrezik për dëbime. Ata kërkojnë që kompanitë e transportit të përjashtohen nga ky rregull dhe paralajmërojnë se bllokada do të zgjasë shtatë ditë nëse brenda kësaj periudhe nuk gjendet një zgjidhje.

Kosova nuk merr pjesë në protestë, por ndien pasojat e saj, pasi pjesën më të madhe të importit dhe eksportit e

realizon përmes transiteve nëpër këto vende.

Për më tepër, edhe shoferët e Kosovës i prek njësoj sistemi EES.

Rasti i kompanisë “Kalaja Epox” në Shtime tregon pasojat e bllokadës edhe në import. Ruzhdi Rexhaj nga kjo kompani thotë se porosia e rrëshirave epokside nga një kompani austriake, tashmë e paguar dhe e ngarkuar, mund të vonohet ose të dështojë. “Çfarë t’u themi klientëve? U kemi thënë tashmë se malli i porositur, ngarkohet më 27 janar dhe vjen deri në fund të javës. Tani, nuk e dimë se kur do të arrijë këtu, ndërkohë që kemi edhe projekte që i kemi filluar, duke shpresuar në këtë material”, thotë Rexhaj për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, çdo vonesë e dëmton edhe reputacionin e kompanisë dhe mund të sjellë gjoba sipas kontratave.

Rrezik për kontratat dhe çmimet

Për të adresuar situatën, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës iu drejtua me një letër presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, duke paralajmëruar se protesta njëjavore mund të shkaktojë pasoja të mëtejshme për kompanitë e Kosovës - përfshirë rrezikimin e kontratave me partnerët evropianë.

Drejtori i kësaj ode, Kushtrim Ahmeti, thotë për Radion Evropa e Lirë, se sa më gjatë të zgjasë bllokada, aq më i madh është dëmi për kompanitë. Ai paralajmëron se vonesat dhe pengesat në transit nuk godasin vetëm bizneset që eksportojnë dhe importojnë, por mund të pasqyrohen edhe te konsumatorët. “... mund të ketë ndikim edhe në çmimet e produkteve në Kosovë, sepse rritet kërkesa për to”, shton Ahmeti. Sipas tij, importi enorm i mallrave nënkupton edhe importimin e krizave. “Çfarëdo që ndodh në vendet prej ku importon, automatikisht ka ndikim. Kjo



është jashtëzakonisht problematike”, thotë ai.

Kosova është importuese e gati të gjitha produkteve - nga ushqimi deri te materiali ndërtimor e tekstili. Sipas të dhënave të Doganës, importet e vitit të kaluar kapën vlerën e mbi 7 miliardë eurove, ndërsa eksportet ishin rreth 942 milionë euro - një bilanc që e bën vendin të ndjeshëm ndaj çdo pengese në transit.

Nisur nga kjo, edhe njohësi i çështjeve ekonomike, Berim Ramosaj, profesor në Universitetin e Prishtinës, thotë se bllokada në kufij krijon presion të drejtpërdrejtë në tregun vendor. “Reflekton keq në ekonomi, e reflekton edhe te konsumatorët, sepse ka gjasa të rriten çmimet”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Importimi i krizave

Me varësinë e madhe nga importi, Kosova ka përjetuar edhe më herët pasojat e krizave të jashtme.

Një nga shembujt më të theksuar ishte viti 2022, kur inflacioni arriti në rreth 14 për qind, si pasojë e çrregullimeve në zinxhirin global të furnizimeve - fillimisht nga pandemia COVID-19 dhe më pas nga lufta në Ukrainë.

Në vitet që pasuan, inflacioni shënoi trend rënieje, por gjatë vitit të kaluar u rikthye sërish në rritje, duke reflektuar presionet e vazhdueshme në treg.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çmimet e prodhimit në vend, në periudhën janar-shtator 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, u rritën për 5.5 për qind.

Mes varësisë nga importi dhe mungesës së mekanizmave mbrojtës

Ekspertët e ekonomisë vlerësojnë se asnjë vend - përfshirë edhe Kosovën - nuk mund të shmangë plotësisht importin e produkteve të caktuara.

Megjithatë, sipas tyre, niveli i lartë i varësisë nga importi e bën vendin veçanërisht të ndjeshëm ndaj krizave të jashtme.

Ramosaj thotë se Kosova, si vend i vogël me bilanc të dobët tregtar dhe me nivel të ulët të integritit evropian, do të vazhdojë të jetë më shumë konsumuese e krizave sesa faktor që i prodhon ato. “Ne jemi aq vend i vogël sa nuk jemi në gjendje të eksportojmë kriza, por gjithmonë t’i marrim faturat e të tjerëve. Kjo është natyra e pozicionit tonë - qoftë në aspektin e zhvillimit ekonomik, politik apo të raporteve që kemi me vendet e Bashkimit Evropian”, thotë Ramosaj. Sipas tij, ky realitet duhet të shërbejë si sinjal për institucionet e vendit që t’i intensifikojnë përpjekjet drejt integritit evropian dhe krijimit të politikave më të qëndrueshme ekonomike.

Ai thekson se për të zbutur ndikimin e krizave të importuara, nevojiten mekanizma të planifikuar mirë, të cilët nuk e dëmtojnë ekonominë e tregut të lirë.

Ai, po ashtu, përmend se shumë vende kanë gjetur forma për të mbrojtur prodhimin vendor, investitorët dhe konsumatorët, qoftë përmes masave doganore, tarifore apo subvencioneve. “Ne ende nuk i kemi këto politika të rregulluara mirë”, vlerëson ai.

Në të njëjtën linjë, edhe Kushtrim Ahmeti, nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, thekson se Qeveria duhet të shqyrtojë masa konkrete për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të prodhuesve vendorë.

Sipas tij, një nga opsionet mund të jetë pezullimi i përkohshëm i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për produktet esenciale dhe të konsumit të përditshëm. Ai thekson se institucionet duhet ta stimulojnë edhe prodhimin vendor të këtyre produkteve. “Kërkesa vendore për produktet esenciale, që janë të domosdoshme për çdo qytetar, do të duhej të mbulohej të paktën 50 për qind nga prodhimi vendor”, thotë ai, duke shtuar se prodhuesit kanë nevojë për një strategji të qartë mbështetjeje, përmes granteve për teknologji, investime dhe mbrojtje të produkteve të tyre në treg.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi Qeverinë në detyrë të Kosovës për çështjen e bllokimit të kufijve qysh më 26 janar, por nuk mori përgjigje.

Në disa raste, ajo ka ndarë subvencione për prodhuesit, por ato nuk kanë arritur të gjenerojnë rritje domethënëse të prodhimit vendor.

BE-ja njoftoi se po punon për lehtësime që do t’u mundësonin shoferëve të kamionëve dhe disa profesionistëve të tjerë qëndrime më të gjata në Zonën Schengen.

Nga një vendim i tillë do të përfitonin direkt edhe qytetarët e Kosovës. “... sepse, kompanitë detyrohen që çdo tre muaj të punësojnë shoferë të rinj”, tha për Radion Evropa e Lirë Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës.

MINNEAPOLIS, ANCHORAGE, HOLLYWOOD: PSE MELANIA TRUMP ËSHTË RIKTHYER NË QENDËR TË VËMENDJES




Në muajt e fundit, Melania Trump është rishfaqur në skenën publike përmes ndërhyrjeve të mirëmbenduar: thirrje për unitet, gjeeste simbolike në fushën gjeopolitike dhe një dokumentar që pritet të dalë së shpejti. Një prani që forcon peshën e saj politike. Për vite me radhë, Melania Trump ishte mungesa më e zhurmshme e politikës amerikane: e pranishme për arsye protokollare, pothuajse e padukshme në debat, e papërshkueshme nga kronika e përditshme që përfshinte presidencën. Megjithatë, në muajt e fundit, zonja e parë është rikthyer në narrativën publike me një sërë ndërhyrjesh të mirëllogaritura: një letër e dorëzuar Vladimir Putinit në samitin e Anchorage, një apel i rrallë për unitet gjatë përshkallëzimit të tensioneve në Minneapolis, dhe tani një dokumentar kushtuar asaj, të

cilin Amazon MGM Studios po e sjell në kinema, në një përmasë të pazakontë për këtë zhanër. Melania Trump ka ndërhyrë në orët e fundit me një thirrje të rrallë për qetësim. Më 27 janar, në një mesazh të përcjellë nga disa media kombëtare, zonja e parë i bëri thirrje vendit që të “bashkohet”, duke theksuar nevojën për protesta paqësore dhe për një klimë më pak të ndezur. Ndërhyrja, e shkurtër dhe pa referenca të drejtpërdrejta ndaj politikave qeveritare, mbarti megjithatë një peshë simbolike të qartë: ndërsa kriza në Minneapolis po merrte përmasa kombëtare, Melania Trump u pozicionua si një zë institucional “anësor”, larg përplasjes politike, por jo plotësisht jashtë skenës. Ky model nuk është i ri. Pararendësi më domethënës daton në verën e vitit 2025. Më 15 gusht, gjatë samitit

mes Donald Trumpit dhe Vladimir Putinit në Anchorage, Alaska, presidenti amerikan i dorëzoi udhëheqësit rus një letër personale të firmosur nga bashkëshortja e tij. Sipas dy zyrtarëve të Shtëpisë së Bardhë, teksti i referohej fatit të fëmijëve të prekur nga lufta në Ukrainë dhe rrëmbimeve të të miturve ukrainas, një nga dosjet humanitare më delikate të konfliktit. Edhe në këtë rast, Zonja e Parë hyri në një moment gjeopolitik me tension të lartë pa u ekspozuar drejtpërdrejt: zëri i saj u përcoll përmes presidentit, në një formë që mbetet simbolike, por politikisht e lexueshme. Elementi i tretë i këtij rikthimi të kontrolluar është dokumentari “Melania”, prodhuar nga Amazon MGM Studios, dalja në kinema e të cilit është planifikuar për 30 janar 2026. Promovimi arriti

kulmin e tij kur zonja Trump i ra gongut të hapjes së bursës së Nju Jorkut (New York Stock Exchange), duke e prezantuar filmin si një projekt që synon të flasë jo vetëm për politikën, por edhe për kulturën pop dhe tregjet. Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që Melania Trump del nga profili i saj tradicionalisht i ulët, por precedentët janë të paktë dhe të kufizuar qartë. Gjatë mandatit të parë të Trumpit, zonja e parë u shfaq kryesisht në raste simbolike: fjalimet në konventat republikane, të menduara për të ofruar një imazh qetësues të presidencës; nisma Be Best kundër bullizmit kibernetik, e lançuar në vitin 2018, por e mbetur e kufizuar në ndërhyrje tematike; si dhe disa mesazhe uniteti dhe dënimi të dhunës pas vrasjes së George Floyd në vitin 2020, kur gjuha e saj, më empatike, u dallua nga ajo e Shtëpisë së

Bardhë. Në të gjitha këto raste, ekspozimi ishte intensiv, por i shkurtër, i ndjekur nga periudha të gjata heshtjeje publike, një dinamikë që e bën edhe më të dukshëm karakterin selektiv të shfaqjeve të muajve të fundit. Pavarësisht këtyre daljeve, profili publik i Melania Trumpit mbetet në përgjithësi i ulët. Disa kronika të muajve të fundit theksojnë se zonja e parë vazhdon ta kufizojë praninë e saj, duke e përqendruar vetëm në momente të caktuara, si periudhat festive apo kalime simbolikisht të rëndësishme. Pikërisht kjo ndërprerje, megjithatë, i jep më shumë peshë rikthimeve të saj dhe nxjerr në pah vështirësitë me të cilat po përballlet Shtëpia e Bardhë. / il giornale – bota.al



FIFA DHE UEFA KONFIRMOJNË NDRYSHIMET STATUTORE TË FFK-së DHE KËRKOJNË PROCES ZGJEDHOR PA NDËRRHYRJE NGA PALË TË TRETA

PRISHTINË, 29 JANAR - Federata Ndërkombëtare e Futbollit (FIFA) dhe Unioni i Federatave Evropiane të Futbollit (UEFA) kanë konfirmuar zyrtarisht se Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka amendamentuar Statutin e saj në përputhje të plotë për harmonizim me kërkesat e UEFA-s dhe FIFA-s dhe Ligjin nr. 08/L-277 për sportin, rekomandimet dhe kërkesat e nxjerra nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në një shkresë të përbashkët drejtuar presidentit të FFK-së, Agim Ademi, FIFA dhe UEFA kanë theksuar se këto ndryshime janë rezultat i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës ndërmjet FIFA-s, UEFA-s, FFK-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke rikujtuar se përfaqësues të dy institucioneve kanë qenë të pranishëm në të gjitha Kuvendet e FFK-së ku janë miratuar ndryshimet statutare. Në të njëjtën kohë, FIFA dhe UEFA kanë nënvizuar rëndësinë e respektimit të parimeve të pavarësisë institucionale dhe zhvillimit të procesit zgjedhor të FFK-së pa asnjë ndërhyrje të padrejtë nga palë të treta, duke sqaruar se çdo vendim që lidhet me qeverisjen dhe anëtarësinë e FFK-së bie ekskluzivisht në kompetencën e organeve të saj statutare. Po ashtu, FIFA dhe UEFA kanë konfirmuar se përfaqësuesit e tyre do të jenë të pranishëm në Kuvendin Zgjedhor të FFK-së më 5 shkurt 2026, për të vëzhguar zhvillimin e procesit në përputhje me Statutin e FFK-së.


SHKRESA E PLOTË TË FIFA-S DHE UEFA-S DREJTUAR FFK-SË:

Inderuar z. Ademi,
I referohemi letrës suaj të datës 19 janar 2026, lidhur me emailin e pranuar më 12 janar 2026 nga

Komisioni për Licencimin e Federatave Sportive të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në lidhje me thirrjen e Kuvendit Zgjedhor të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), i cili është planifikuar të mbahet më 5 shkurt 2026. Në këtë kontekst, rikujtojmë se ndryshimet në Statutin e FFK-së fillimisht janë miratuar në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të mbajtur në Prishtinë më 27 janar 2023, duke prezantuar një sërë reformash thelbësore që synonin forcimin e ndjeshëm të qeverisjes dhe të kornizës statutare dhe rregullative të FFK-së.

Më tej, FFK ka mbajtur Kuvendin e Rregullt më 20 shkurt 2024, gjatë të cilit ka miratuar Kodin Zgjedhor të FFK-së dhe ka zgjedhur anëtarët e Komisionit Zgjedhor. Në Kuvendin e Rregullt pasues të datës 5 shkurt 2025, si dhe në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të mbajtur më 11 gusht 2025, janë miratuar ndryshime shtesë statutare me qëllim të harmonizimit të Statutit të FFK-së me parimet dhe rekomandimet e FIFA-s dhe UEFA-s, si dhe me Ligjin nr. 08/L-277 për Sportin dhe rekomandimet dhe kërkesat e nxjerra nga MKRS. Përfaqësues të FIFA-s dhe UEFA-s kanë marrë pjesë në të gjitha këto Kuvende për të siguruar që proceset përkatëse janë zhvilluar në përputhje me standardet e qeverisjes së të dyja institucioneve.

Të gjitha reformat e lartpërmendura, të cilat parashihnin ndryshime gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e strukturës qeverisëse të federatës, kanë qenë rezultat i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës dhe të koordinuar, ku kanë marrë pjesë FIFA, UEFA, FFK-ja dhe MKRS-ja. Për më tepër, rezultoni se çdo version i rishikuar i Statutit të FFK-së është komunikuar rregullisht të të gjitha palët relevante, përfshirë



MKRS-në, deri dhe te ndryshimet e fundit të miratuara nga Kuvendi i Jashtëzakonshëm më 11 gusht 2025. Prandaj, vlerësojmë se, duke qenë se këto ndryshime të fundit janë ndërmarrë pikërisht për të siguruar përputhshmëri me legjislacionin vendor për sportin dhe duke pasur parasysh mungesën e dukshme të komenteve apo kundërshtimeve nga MKRS për më shumë se pesë muaj, nuk ka pasur më asnjë tregues për pengesa të mundshme në përputhje me legjislacionin përkatës vendor për sportin. Në këtë drejtim, e konsiderojmë tejet shqetësuese që, pas Kuvendit të Jashtëzakonshëm të 11 gushtit 2025, MKRS-ja vetëm më 12 janar 2026 - pra vetëm disa javë para zgjedhjeve të FFK-së të planifikuara për më 5 shkurt 2026 - ka kërkuar ndryshime thelbësore në Statutin e FFK-së, veçanërisht lidhur me dispozita që janë futur në Statutin e FFK-së që nga viti 2023 dhe që, sipas njohurive tona, nuk janë vënë në dyshim në asnjë fazë të procesit të konsultimit deri më tani.

Në këtë kontekst, dëshirojmë t'ju

tërheqim vëmendjen te neni 14 paragrafi 1 (i) dhe neni 19 i Statutit të FIFA-s, si dhe neni 7 bis paragrafi 2 i Statutit të UEFA-s, të cilat kërkojnë që Federatat anëtare t'i menaxhojnë punët e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të padrejtë nga asnjë palë e tretë. Në bazë të këtyre dispozitave, Federatat anëtare duhet të sigurojnë, përmes statuteve të tyre, një procedurë demokratike që garanton se organet ekzekutive zgjidhen lirshëm dhe në mënyrë demokratike dhe se të gjitha organet e tjera zgjidhen ose emërohen në mënyrë plotësisht të pavarur. Çdo shkelje e këtyre detyrimeve mund të çojë në sanksione, përfshirë edhe rastet kur një ndikim i tillë nga palët e treta nuk i atribuohet drejtpërdrejt fajit të Federatës anëtare. Në përputhje me këtë, pritshmëria jonë e qartë është që procesi zgjedhor i FFK-së të zhvillohet me transparencë dhe pavarësi të plotë, dhe pa asnjë ndërhyrje të padrejtë nga palë të treta, në përputhje me parimet e qeverisjes që zbatohen për të gjitha Federatat anëtare të FIFA-s dhe UEFA-s. Po ashtu, në

përputhje me këto parime, dëshirojmë të theksojmë se, siç përcaktohet në Statutin e FFK-së, çdo vendim që lidhet me përbërjen e anëtarësisë së FFK-së bie në kompetencën ekskluzive të Kuvendit të FFK-së, si organi suprem dhe legjislativ i FFK-së, i cili po ashtu duhet të mbetet i lirë nga çdo formë ndikimi apo vendimarrjeje nga palë të treta. Më tej, dëshirojmë të theksojmë arritjen historike sportive të kualifikimit të kombëtares së Kosovës në Play-off-in e Kualifikimeve Evropiane për Kampionatin Botëror FIFA 2026, si dhe të nënvizojmë rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit institucional në këtë moment kritik, në mënyrë që të mos rrezikohet zhvillimi dhe suksesi i mëtejshëm i futbollit në Kosovë. Gjithashtu, ju njoftojmë se përfaqësues të FIFA-s dhe UEFA-s do të marrin pjesë dhe do të vëzhgojnë Kuvendin Zgjedhor të FFK-së më 5 shkurt 2026, për të siguruar që procesi zgjedhor të zhvillohet në përputhje me Statutin e FFK-së, si dhe me statutet, rregulloret dhe parimet përkatëse të FIFA-s dhe UEFA-s. Së fundi, duke qenë se statutet e një Federate anëtare konsiderohen si një "dokument i gjallë" që kërkon ndryshime herë pas here për të ruajtur standarde të larta të qeverisjes së mirë, pas Kuvendit Zgjedhor, FIFA dhe UEFA do t'ju kontaktojnë për të vlerësuar çdo ndryshim të mundshëm të mëtejshëm në Statutin e FFK-së që mund të miratohet në kohën e duhur. Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj dhe mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo sqarim të mëtejshëm që mund t'ju nevojitet.

Me respekt,

FIFA - Elkhan Mammadov, shef për Federatat Anëtare
UEFA - Thierry Favre, drejtor për Zhvillim të Federatave Kombëtare.


Pesë skuadra angleze kualifikohen direkt në Ligën e Kampionëve, Real, Interi dhe PSG-ja mbesin jashtë top tetëshes

PRISHTINË, 29 JANAR - Ka përfunduar xhiroja e 8, njëkohësisht e fundit e fazës së Ligës së Kampionëve. Tashmë dihen tetë skuadrat që e kanë siguruar kualifikimin direkt në 1/16-n, e jashtë saj ka mbetur Real Madridi që kualifikimin duhet ta kërkojë në "play-off"

pas humbjes nga Benfica me rezultat 4:2. Direkt vazhdojnë tutje pesë skuadra angleze: Arsenal, Liverpool, Tottenham Hotspur, Chelsea dhe Manchester City si dhe Bayern Munchen, Sporting dhe Barcelona. Kurse skuadra e Jose Mourinhos, Benfica, është

kualifikuar në frymën e fundit. Jashtë top tetëshes kanë mbetur edhe Interi dhe Paris Saint Germaini. Skuadrat që kanë mbetur jashtë top tetëshes: Real Madridi, Interi, PSG-ja, Newcastle, Juventus, Atletico, Atalanta, Leverkusen,

Dortmund, Olympiacos, Brugge, Galatasaray, Monaco, Qarabag, Bodo Glimt, Benfica. Çiftet përfundimtare do të përcaktohen sot (e premte) nga shorti, i cili do të zhvillohet në Shtëpinë e Futbollit Evropian në Nyon dhe do të transmetohet drejtpërdrejt në



"Uefa.com" dhe në aplikacionin zyrtar të Ligës së Kampionëve të UEFA-s.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “G Project” Sh.p.k., Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror – rërës dhe zhavorit dhe inerteve në Z.K. Zhur, Komuna Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.03.2026 në ora 11:00 në Objektivin e Kuvendit Komunal, Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania “G Project” Sh.p.k., Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/88599021829?>

Passcode: yt8ScC

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “G Project” Sh.p.k., Prizren, për Pëlqim Mjedisor, për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror – rërës dhe zhavorit dhe inerteve në Z.K. Zhur, Komuna Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Met Bat” Sh.p.k., Glllogoc, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën e rikuperimit të materialeve të klasifikuara, grumbullimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja) në Sankovc, Glllogoc.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.03.2026 në ora 10:00 në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Luigj Gurakuqi” Fshati Sankoc, Komuna e Glllogocit do të organizohet debat publik nga Kompania “Met Bat” Sh.p.k., Glllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Met Bat” Sh.p.k., Glllogoc, për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën e rikuperimit të materialeve të klasifikuara, grumbullimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja) në Sankovc, Glllogoc.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Insta Green Energy" L.L.C. Obiliq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 90 MW dhe 30 MWh sistem të ruajtjes së energjisë”, nga Kompania “Insta Green Energy” L.L.C., Rufci i Ri – Rufc i Vjetër – Dobrajë e Madhe dhe Torinë, Komuna e Lipjanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.03.2026 në ora 10:00 në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Migjeni” në fshatin Rufc i Ri, Lipjan do të organizohet debat publik nga Kompania “Insta Green Energy” L.L.C. Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Insta Green Energy” L.L.C. Obiliq, për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 90 MW dhe 30 MWh sistem të ruajtjes së energjisë”, nga Kompania “Insta Green Energy” L.L.C., Rufci i Ri – Rufc i Vjetër – Dobrajë e Madhe dhe Torinë, Komuna e Lipjanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

“FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjinnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjinnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

